

EKSTRAKT NGA INTERVISTA

[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 15 maja, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]

Intervistuesja: Kur e keni ble banesën, a e keni ble prej punës juj apo e keni trashëgu a?

Narratorja: Pak trashëgim, atje e kemi shitë ni pjesë tokës edhe e kemi dhonë atë pjesë të pareve, pjesën tjetër jemi tu e dhonë tash, për tetë vjet e kemi.

Intervistuesja: Sa paguni?

Narratorja: 300 euro në mujt.

Intervistuesja: A osht' shumë për juve?

Narratorja: Po mirë po ja dalim niherë, amo pak osht' shumë.

Intervistuesja: E qysh ka qenë qeky viti pandemik? A ta ka ndryshu najfarë mënyre jetën?

Narratorja: Paj, po, atëherë mo tre mujë që s'punum as burri. Edhe këto të shtetit që dulën edhe këto nuk dulën me kohë, pak me vonesë. Tash apet që u mbyll dy javë, apet qe dje e qitën, a din, pak, po normal pak po. Nja dy muj s'kemi mujt me pagu, po na nuk e kena me bankë, e kena me pronarin e banesës, ai pronari na ka kuptu edhe mirë. Dy muj s'e kemi pagu, tash vazhdojmë normal me pagu.

Intervistuesja: A i ki ti prindët?

Narratorja: Po, po, i kam.

Intervistuesja: A janë hala...

Narratorja: Po, jonë në Emshir, po. Gjallë janë. I kom vllaznitë, vllaznitë e martumë, katër vllazën të martumë, janë nëpër shpija të veta. Kanë bo shpija.

Intervistuesja: Qaty në të njejtin vend?

Narratorja: Qaty njejtin vend. Kena pasë dhetë ari tokë, e i kanë ndërtu shpijat.

Intervistuesja: Veç për vllazën apo edhe për motra?

Narratorja: Jo, për motrat jo, s'ka vend edhe për motrat. Për vllaznitë, të katërtit janë aty.

Intervistuesja: A ju kanë dhonë prindët diçka juve çikave a jo?

Narratorja: Jo, niherë jo.

Intervistuesja: A osht' në plan?

Narratorja: Ka thonë babi, "Po, ka". Amo, niherë, në bazë të kushtev niherë jo.

Intervistuesja: E qysh keni vendosë me shku në Fushë Kosovë me jetu?

Narratorja: Kemi vendos se këtu pak shtrejtë, e normal që puna të shtetit diçka jo, e s'mujshim mo me ble këtu në Prishtinë. Edhe vendosëm në fund atje në Fushë Kosovë që me ble.

Intervistuesja: E Fushë Kosova qysh osht' me jetu atje?

Narratorja: Mirë, në fillim m'u ka dokë edhe aty pak ronë deri sa jom adaptu, po mirë osht', s'osht' keq.

Intervistuesja: E çka të pengojke?

Narratorja: Më pengojke pak ajri, ajri në mramje pak i Obiliqit, vike pak era në mramje, më pengojke qajo shumë. Tash jom adaptu edhe s'po di mramje ashtu nuk dal nashta, a din, dritaret e mbylluna. Nashta jom adaptu edhe aty, a po din, amo tash s'më doket keq, në fillim pak m'u doke keq. Nashta edhe ambientin kur e ndrrova, a din. Tash prej katuni me dalë në Fushë Kosovë osht', osht' tjetër normal. Atje osht' ajri shumë i pastërt, këtu osht' ajri ma i ndotur.

Intervistuesja: E për fëmitë qysh ka qenë?

Narratorja: Po për fëmitë edhe ata qishtu pak, djali osht' pak ma i madh. Djalit p'i pëlqen atje natyrë me dalë, në fshat atje. Në vikend shkon gjithherë, shkon te gjyshja atje. Vjehri më ka vdekë vjet e te gjyshja shkon, te kunati. Çdo vikend thuj se ai po shkon.